



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 12 Regj.Them.

Nr. 12 VENDIMI

Datë 12.04.2023 Regj.Them

Datë 18.04.2023 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Emona MUÇI	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Alma KOLGJOKA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Manjola XHAXHO	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtar:	Sokol IBI	<i>(Anëtar)</i>
Gjyqtare:	Esmeralda XHILI	<i>(Anëtare)</i>

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë **18.04.2023**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. **12** akti, datë **12.04.2023** që i përket:

PADITËS: **Subjekti zgjedhor, Partia e Unitetit Kombëtar (PUK)**, përfaqësuar nga z. **Vebi Hana**, i biri i Tahirit, i datëlindjes 01.05.1960, lindur në fshatin Skëndërbe dhe banues në Librazhd, fshati Rrajce, shtëpi private nr. 21/94, në cilësinë e Kandidatit për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, propozuar nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK).

IPADITUR: **Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve**, përfaqësuar nga Ina Osmanaj dhe/ose Erdal Mema, pajisur me Autorizim nr.3880 prot., datë 17.04.2023

OBJEKTI: -Kundërshtimin e vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

-Ndryshimin e këtij vendimi duke regjistruar z. Vebi Tahir Hana, si Kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, i propozuar nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), për

zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 01, datë 23.12.2020 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modele të kandidimit”.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

në seancën e datës **18.04.2023**, pasi dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

1. Se pala paditëse, subjekti Vebi Hana i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Kundërshtimin e vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve; Ndryshimin e këtij vendimi duke regjistruar Z. Vebi Tahir Hana, si Kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, i propozuar nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023*”.
2. Nga aktet e dosjes rezulton se më datë 12.04.2023 pala paditëse ka paraqitur kërkesë padinë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nëpërmjet shërbimit postar (*dorëzuar në postë më datë 11.04.2023.2023*), brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.
3. Kërkesë padia rezultoi fillimisht të mos jetë paraqitur në respektim të plotë të formës dhe të paraqitjes së saj, kritere këto të përcaktuara në nenin 153 të Kodit Zgjedhor. Për pasojë Kolegji Zgjedhor mori vendim “Për caktimin e seancës gjyqësore dhe lënien afat për plotësimin e të metave të kërkesë padisë”, duke i lënë kohë/afat 24 orë palës paditëse për plotësimin e këtyre të metave. Pala paditëse brenda afatit të caktuar paraqiti padinë më datë 18.04.2023 në formën e kërkuar nga ligji.
4. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E CËSHTJES:

5. Pala paditëse/ subjekti subjekti Vebi Hana ka nënshkruar deklaratën për pranimin e kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si kandidat për Kryetar i Bashkisë Prrenjas, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Unitetit Kombëtar (PUK). Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, ka autoritetin dhe përgjegjësinë e nxjerrjes së akteve nënligjore për rregullat për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe afatet për zbatimin tyre në përputhje me Kodin Zgjedhor.
6. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Për të qenë pjesë e këtyre zgjedhjeve, subjekti Vebi Hana ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u regjistruar si kandidat për Kryetar i Bashkisë Prrenjas, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Unitetit Kombëtar (PUK) në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.
7. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas, në mbledhjen e datës 27.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Prrenjas, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023, por për shkak të mangësive të këtij dokumentacioni i ka dhënë mundësi që brënda 48 orëve të bëhet plotësimi i dokumentacionit pranë KZAZ nr. 53, Prrenjas
8. Në këtë njoftim/vendim KZAZ nr. 53 Prrenjas me lëndë: *Kërkesë për plotësim dokumentacioni* parashtron sa më poshtë se;

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas, i ngritur për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14.05.2023, në mbledhjen e datës 27.03.2023, shqyrtoi çështjen me objekt: “Shqyrtimi i kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në Bashkinë Prrenjas, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë nesh në datë 27.03.2023, rezulton se keni mangësi në dokumentacion:

I gjithë dokumentacioni i sjellë nga ana juaj është jo i rregullt:
 1. Kërkesa për regjistrim për kandidat për kryetar bashkie, nuk është firmosur nga përfaqësuesi i partisë/ subjekti zgjedhor Partia Uniteti Kombëtar.
 2. Kërkesat për kandidat për kryetar bashkie, janë të gjitha pa vulën e partisë/ subjekti zgjedhor Partia Uniteti Kombëtar.

3. Autorizimin e bashkëlidhur dokumentacionit që keni nga përfaqësuesi i partisë z. av. Idajet Beqiri, është vetëm që ju të regjistroni kandidatët për këshilltarë dhe jo të propozoni apo të miratoni kandidatët qoftë për këshilltar apo kryetar.
4. Ju keni depozituar një deklaratë me shkrim dore, nëpërmjet së cilës keni shprehur dëshirën që do kandidoni për kryetar për bashkinë për zgjedhjet për organete qeverisjes vendore të datës 14.05.2023, pra nuk është sipas formatit të miratuar nga KQZ.
5. Gjithashtu, nga verifikimi rezulton se ju nuk jeni zgjedhës pranë KZAZ 53, Bashkia Prrenjas. Në zbatim të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke qenë përpara faktit që ka mungesë dokumentacioni, KZAZ 53 Prrenjas, nuk mund të marrë vendim për Regjistrim të kërkesës tuaj për kandidim për kryetar bashkie Plotësimi i dokumentacionit, duhet të bëhet brenda 48 orëve, pranë KZAZ 53 Prrenjas, me adresë Ish Kinoklubi Prrenjas, në të kundërt kërkesa juaj nuk do të regjistrohet dhe për rrjedhojë, nuk mund të merrni pjesë në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14.05.2023, *(subjekti paditës/ankues ka nënshkruar dhe ka bërë shënimin: Mu dha dorazi më datë 30.03.2023 ora 18:00).*
- 9.** Në lidhje me këtë vendim për plotësim dokumentacioni, subjekti ankues pretendon se ka marrë dijeni më datë 30.03.2023 dhe ka bërë plotësimet e kërkuara brenda 48 orëve nga marrja dijeni.
- 10.** Në vijim, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas, me vendimin nr. 19, datë 30.03.2023 ka vendosur: *“1. Mosregjistrimin e Z. Vebi Tahir Hana si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor nga Partia Unitetit Kombëtar (PUK) për mangësi të dokumentacionit. 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij. 3. Një kopje e këtij vendimi dërgohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe një kopje i jepet kërkuarit.”*
- 11.** Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas ka arsyetuar se:
- ”Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.53, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe konstatoi se kushtet e parashikuara në nenin 70, të Kodit Zgjedhor*
- NUK PLOTËSOHEN”**
- 12.** Kundër këtij vendimi pala paditëse/subjekti Vebi Hana ka paraqitur ankesë më datë 05.04.2023 drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt: “Kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas datë 30.03.2023. Ndryshimin e vendimit duke vendosur regjistrimin e z, Vebi Tahir Hana si Kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas, i propozuar nga

Partia Uniteti Kombëtar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” duke parashtruar ndër të tjera se:

- *Subjekti Vebi Hana si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas i autorizuar nga Partia Uniteti Kombetëre (PUK) ka paraqitur disa dokumente prane KZAZ 53 Prrenjas në datën 27.03.2023 ku u plotësua dhe një fletë për dokumentat që dorëzoi. Është paraqitur përsëri në datën 30.03.2023 për dorëzimin e dokumenteve plotësuese dhe aty ka marrë dijeni për vendimin e datës 28.03 2023 për plotësim dokumentacioni. Pas dorëzimit të disa dokumenteve rezulton se ishte dhe kriter vendbanimin dhe dy dokumenta të tjerë që kishin lidhje me subjektin politik. Për këtë shkak iu la afat për ti dorëzur më datë 31.03.2023 duke sjellë edhe dokumentin e transferimit.*
- *Subjekti ankues pretendon se përpara këtij afati, nëpërmjet telefonit ka marrë dijeni nga përfaqësuesi i KZAZ-së se vendimi ishte marrë duke mos iu dhënë mundësia e dorëzimit të plotë të dokumentacionit.*
- *Vendimin objekt ankimi e ka marrë në datën 03.04.2023, ora 11 në Kinostudio Tiranë duke pretenduar se ishte futur në thes për tu hedhur.*

13. Kërkesa ankimore i'u paraqit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili me vendim nr. 49, datë 06.04.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 të depozituar nga z. Vebi Tahir Hana.”, ka vendosur

- 1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023, të paraqitur nga Z. Vebi Tahir Hana, për shkak se është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit.*
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.*

14. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:

- *Z. Vebi Tahir Hana ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 47 regj., datë 05.04.2023.*
- *Në mbledhjen e datës 06.04.2023, ora 13:30, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 47 nuk i plotësonte kërkesat e nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës*

së Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht pikën 1, shkronjën “c” të nenit 130, pasi është paraqitur në datën 05.04.2023 pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë që vendimi objekt kundërshtimi është marrë nga KZAZ-ja nr. 53 Prrenjas, në datën 30.03.2023. Pra, z. Hana e ka depozituar kërkesën ankimore jashtë afatit.

- Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

15- Pala paditëse subjekti Vebi Hana pasi është bërë me dije me vendimin e KAS, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Kolegjit (Gjykatës) me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se:

- Vendimi nr. 19, datë 30.03.2023, i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 53, Prrenjas, ankuesit i është komunikuar nëpërmjetë shërbimit postar. Zarfë i komunikimit mban datën 31.03.2023 por ankuesi pretendon se ka marrë dijëni me datë 03.04.2023 si edhe ka firmosur në po të njëjtën datë për marrje dijëni.
- Rezulton se Komisioni i Ankimeve dhe Sankioneve pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ka vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 për shkak se ankimi është paraqitur jashtë afateve ligjore. Në lidhje me këtë, ashtu si edhe u sqarua më sipër ankuesi pretendon se nuk ka pasur dijëni për vendimarrjen e Komisioni të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe nuk kishte se si të ushtronte të drejtën e ankimit brënda 3 ditëve nga shpallja e këtij vendimi sepse pavarësisht interesimit herë pas herë pranë këtij Komisioni, i është bërë me dije se vendimi ende nuk është zbardhur si edhe që i është dërguar me postë. Ankuesi pretendon se të drejtën e ankimit e ka ushtruar nga momenti që i është komunikuar vendimarrja e tyre.
- Për pasojë, tashmë që të gjitha kërkesat e parashikuara në ligj për t’u rregjistruar si Kandidat për Kryetarë Bashkisë, janë të plotësuar e kërkon pranimin e kërkesës sipas objektit të ankimit.
- Pala e paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në seancën gjyqësore në datë 18.04.2023, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka paraqitur prapësime, duke parashtruar këto shkaqe për rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi z. Vebi Tahir Hana dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47,

datë 05.04.2023 të depozituar nga z. Vebi Tahir Hana", të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

- *Paditësi, Vebi Tahir Hana ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 47 regj., datë 05.04.2023.*
- *Në seancën e datës 06.04.2023 të KAS-it, u konstatua se pas shqyrtimit të elementëve të verifikimit paraprak, referuar nenit 130, pika 1, shkronja "c", kërkesa ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 është depozituar përtej afatit ligjor, pasi vendimi nr. 19, i KZAZ nr. 53, Prrenjas rezulton të jetë marrë me datë 30.03.2023. Afati i ankimit pranë KAS përfshin periudhën 3 ditore nga dita e marrjes së vendimit në KZAZ. Ankuesi ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën et ij në datën 05.04.2023, duke tejkuluar afatet ligjore për ankim.*

16. Pala e paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në seancën gjyqësore në datë 18.04.2023, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka paraqitur prapësime, duke parashtruar këto shkaqe për rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi z. Vebi Tahir Hana dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 të depozituar nga z.Vebi Tahir Hana", të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

- *Paditësi, Vebi Tahir Hana ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 47 regj., datë 05.04.2023.*
- *Në seancën e datës 06.04.2023 të KAS-it, u konstatua se pas shqyrtimit të elementëve të verifikimit paraprak, referuar nenit 130, pika 1, shkronja "c", kërkesa ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 është depozituar përtej afatit ligjor, pasi vendimi nr. 19, i KZAZ nr. 53, Prrenjas rezulton të jetë marrë me datë 30.03.2023. Afati i ankimit pranë KAS përfshin periudhën 3 ditore nga dita e marrjes së vendimit në KZAZ. Ankuesi ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën e tij në datën 05.04.2023, duke tejkuluar afatet ligjore për ankim.*

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

- 17.** Në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Prrenjas, z.

Vebi Hana Kolegji Zgjedhor konstaton se partia “Partia e Unitetit Kombëtar (PUK)”, është regjistruar pranë KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023. Në vijim të procedurave për regjistrimin në zgjedhjet vendore, ky subjekt zgjedhor, në zbatim të nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor sipas të cilit: “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar bashkie të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë, regjistrohen në KZAZ-në që bulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë”, i është drejtuar KZAZ nr. 53 Prrenjas, për të regjistruar z. Vebi Hana si kandidat për kryetar të Bashkisë Prrenjas. Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Kodi Zgjedhor për regjistrimin e një kandidati, subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar (PUK),” dhe kandidati i saj z. Vebi Hana, kanë depozituar pranë KZAZ nr. 53 Prrenjas, dokumentacionin përkatës për regjistrimin e kandidatit, sipas listës përkatëse të dokumentuar në procesverbalin model KQZ-00-31, dorëzuar më datë 27.03.2023 (protokolluar pranë kësaj të fundit me nr. 18 prot.) Pjesë e listës së dokumentave të depozituara pranë KZAZ nr. 53 Prrenjas janë

-Formulari për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (model KQZ-04-01 në kollonën dorëzoi rezulton JO);

-deklaratë e angazhimit solemn të kryetarit të partisë (model KQZ-04-02 në kollonën dorëzoi rezulton JO),

-deklaratë për hapje llogarie të posaçme bankare (Model KQZ-04-03 në kollonën dorëzoi rezulton JO),

-kërkesë për regjistrimin e Komitetit nismëtar (Model KQZ-04-04 në kollonën dorëzoi rezulton JO),

-kërkesë për regjistrimin e listës shumëemërore për anëtarë të këshillit bashkiak të propozuar nga parti politike/koalicion (Model KQZ-04-07 në kollonën dorëzoi rezulton JO);

-kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie i propozuar nga parti politike/koalicion (Model KQZ-04-06 në kollonën dorëzoi rezulton JO);

18. Referuar vendimit të KZAZ nr. 53 Prrenjas që është objekt kundërshtimi pranë Kolegjit Zgjedhor, rezulton se ky i fundit ka konkluduar se kushtet e parashikuara në nenin 70, të Kodit Zgjedhor NUK PLOTËSOHEN bazuar kjo në procesverbalin të dorëzimit të dokumentave të kandidimit (plotësues) protokolluar pranë KZAZ nr. 53 Prrenjas me nr. 30 prot., datë 30.03.2023 nga ku rezulton se: dokumentat e sipërcituara ‘në kollonën dorëzoi rezulton JO’ nuk janë dorëzuar nga paditësi me përrishtëm të kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie i propozuar nga parti politike/koalicion Model KQZ-04-06 (i firmosur dhe i vulosur) sikurse edhe në procesverbalin me nr. 18 prot., datë 27.03.2023.

19. Kolegji Zgjedhor, vlerëson se vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve sipas të cilit ka vendosur “Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 05.04.2023 për shkak se ankimi është paraqitur jashtë afateve ligjore”, është i bazuar në ligj.
20. Në pjesën e X të Kodit Zgjedhor, “ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE I VENDIMEVE TË KOMISIONEV EZGJEDHORE”, Neni 124 titulluar “E drejta e ankimit”, (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012) parashikohet se: “1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. 2. .. 5. Të drejtën e ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektete përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve. Vendimet e KQZ-së për regjistrimin apo refuzimin për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, të marra në zbatim të pjesës IV të këtij Kodi, ankimohen sipas kreut I të pjesës XI të këtij Kodi në Kolegjin Zgjedhor.”. Për sa parashikon vetë Kodi si më sipër, rezulton për Kolegjin se nuk është i mbshtetur në ligj pretendimi i paditësit se vendimi objekt ankimi i është njoftuar këtij subjekti jashtë afatit për ta kundërshtuar vendimmarrjen e KZAZ-së pranë KAS-it. Vetë Kodi parashikon fillimin e afatit nga momenti i shpalljes së vendimit dhe jo nga momenti i njoftimit.
21. Sipas Nenit 125 titulluar “Llogaritja e afateve” (Ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012) parashikohet se: “1. Afatet që në Pjesët X dhe XI të këtij Kodi janë përcaktuar me orë llogariten duke përjashtuar orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë Kod llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky Kod është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 8:00 e ditës pasardhëse. 2. Afatet që në këtë pjesë janë përcaktuar me ditë llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. 3. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 2 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, të përcaktuar në vendimin e KQZ-së, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse. 4. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës. 5. Për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese, nuk mund të ketë rivendosje në afat. 6. Për efekt të këtij neni, në rast se nga KQZ-ja nuk është përcaktuar ndryshe me vendim, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8:00 deri në orën 16:00 dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel.”. Në këtë dispozitë shihetqartë vullneti i legjislatorit për të moslejuar rivendosje në afat në lidhje me afatet e ankimit sipas kësaj pjese.

22. Bazuar në nenin 130, pika c e Kodit Zgjedhor, sipas të cilit: “KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme: a)...c) **respektimin e afateve ligjore për ankimin.**

Kolegji Zgjedhor pavarësisht sa më sipër, vlerëson se depozitimi i ankimit ndaj vendimit Nr 19, datë 30.03.2023 të KZAZ nr. 53 Prrenjas gjithashtu rezulton të jetë bërë jashtë afateve (maksimale) të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Koncretisht, në nenin 73 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor parashikohet shprehimisht se: “1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim **jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve.** 2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet **jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve.** Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit **përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre**”.

23. Në lidhje me afatet e përcaktuara më sipër, të cilat janë prekluzive vjen në ndihmë edhe praktika tashmë e konsoliduar gjyqësor ku referuar vendimit nr. 2, datë 27.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatohet se është rregull gjerësisht i pranuar se dies a quo nuk llogaritet në afatin kohor brenda të cilit verifikohet një ngjarje apo duhet të kryhet një veprim i caktuar, rregull ky i cili ka gjetur shprehjen e tij edhe në Kodin e Procedurës Civile të Shqipërisë në nenet 148, 433, 444/1 të K.Pr.Civile. Në rastin konkret vlen për t’u theksuar parimi “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”, parim kushtetues ky që gjen shprehje në nenin 18/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga ky parim i sanksionuar në aktin normativ me fuqi mbizotëruese në Republikën e Shqipërisë (neni 116/1/a i Kushtetutës) gjen burim dhe parimi i “barazisë së armëve”, dispozita këto që u njohin të njëjtat të drejta/detyrime palëve ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor civil në gjykatat e sistemit gjyqësor shqiptar... Në interpretim të dispozitave të mësipërme kolegji vlerëson se subjekti ka pasur gjithë kohën e nevojshme që brenda afatit të parashikuar në nenin 73 të Kodit Zgjedhor të bënte paraqitjen e gjithë dokumentacionit të kërkuar dokumentacioni i cili jo vetëm nuk është plotësuar por ka mbetur i tillë sipas procesverbalit të datës 30.03.2023, që korrespondon me datën e marrjes/shpalljes së vendimit objekt ankimi. Në deduksion të sa më sipër, paditësi ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me KZAZ 53 Prrenjas dhe prej provave të dokumentuara ai ka qënë i mirëinformuar lidhur pasaktësinë e dokumentave të paraqitura. Afati i ankimit të tij pranë KQZ fillonte që në momentin e shpalljes së këtij vendimi ashtu sikurse Kodi Zgjedhor (i ndryshuar) e ka parashikuar shprehimisht dhe jo nga momneti i dorëzimit me postë të këtij vendimi. E gjithë fryma e Kodit Zgjedhor dhe e veprimtarisë vendimmarrëse të organeve të parashikuara nga ky Kod, jetëson një proces të shpejtë, dinamik dhe pa vonesa, por gjithmonë duke respektuar edhe të drejtat e subjekteve zgjedhor apo subjekteve të tjera që sipas këtij Kodi ndërveprojnë në këtë proces shumë të

rëndësishëm. Në këtë kuadër Kodi ka parashikuar edhe përfaqësues të përhershëm pranë organeve që Kodi parashikon apo zhvillimin e seancave publike dhe transparente.

24. Kolegji Zgjedhor vlerëson *se edhe nëse* do të prezumohej se subjekti paditës do të ishte brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, mosplotësimi i dokumentacionit çon në mosplotësimin e kërkesave ligjore pasi afatet e parashikuara më sipër janë strikte e për rrjedhojë në mosregjistrimin në rastin konkret të subjektit z. Vebi Tahir Hana si kandidat për Kryetar të Bashkisë Prrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor nga Partia Unitetit Kombëtar (PUK), për mangësi të dokumentacionit.
25. Kolegji pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, vlerëson se padia me paditës Vebi Hana duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e kërkesë padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore si janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, në datë 18.04.2023.

GJYQTARE
Manjola XHAXHO

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTARE
Emona MUÇI

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Esmeralda XHILI